



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE

RAPORTI VJETOR

2012

PËRMBAJTJA

1. Përfituesit e programit

- **Identifikimi dhe referimi**
- **Profili i viktimave të trafikimit**

2. Shtyllat kryesore të punës së D&E gjatë vitit 2012

- **Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktime të trafikimit në Shqipëri**
- **Identifikimi dhe asistimi i meshkujve viktime të trafikimit**
- **Rritja e përpjekje për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit**
- **Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale**
- **Aktivitete ndërgjegjësuese për respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri**
- **Aktivitete për të parandaluar trafikimin dhe promovuar migracionin e sigurt**

3. Trajnime të ofruara nga D&E

4. Pjesëmarrja e stafit në trajnime

5. Koordinime me Aktorë të tjerë Kundër Trafikimit

6. Përmbledhje e projekteve të zbatuara gjatë 2012

1. PËRFITUESIT E PROGRAMIT

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2012** janë asistuar në programin riintegrues të organizatës 75 përfitues dhe 28 fëmijë të tyre nga të cilat 42 raste dhe 17 fëmijë kanë hyrë për herë të parë në program gjatë kësaj periudhë, ndërsa rastet e tjera janë të mbartura dhe kanë vazhduar të marrin ndihmë sipas planit të riintegritimit.


KATEGORITË E PËRFITUESVE TË ASISTUAR NË PROGRAM

Kategori	Total i rasteve të asistuara në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012	Rastet e mbartura nga Dhjetor 2011	Rastet e reja në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012
Viktima trafikimi/Viktima të mundshme trafikimi	72	32	40
Viktima të dhunës dhe abuzimit	3	1	2
Fëmijë të VeT shoqëruar me nënat e tyre	28	11	17
Totali	103	44	59

IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI

Viti 2012 shënon një rritje në numrin e referimit të viktimave të trafikimit ose viktimave të mundshme të trafikimit, krahasur me vitin 2011. Nga 23 referime në vitin 2011, në vitin 2012 numri i referimeve shkon në 42, gati dyfishi i referimeve të një viti më parë. Gjatë gjithë vitit ka pasur një numër të konsiderueshëm referimesh, ku muaji Maj shënon edhe numrin më të lartë, 10 raste janë referuar për herë të parë në programin e D&E gjatë këtij muaji. Përveç kësaj, vihet re një numër i lartë referimesh që kanë të bëjnë me rastet të shoqëruara nga fëmijët e tyre. 17 është numri i fëmijëve të hyrë në program gjatë këtij viti të shoqëruar nga nënat e tyre.

Burimet kryesore të referimit të rasteve të reja për vitin 2012 janë si mëposhtë:




Gjatë vitit 2012 D&E ka bashkëpunuar me organizatën Refugee Action për kthimin e një rasti viktimë trafikimi nga Anglia e cila vazhdon të ndihmohet nga programi i organizatës. Për kthimin e rastit është bashkëpunuar gjithashtu me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik dhe Autoritetin Përgjegjes. Duke qenë se rasti është kthyer në familjen e saj të origjinës, ndihma e ofruar i është dhënë jo vetëm asaj por të gjithë familjes. D&E ka bashkëpunuar me Zyrën Rajonale të Shërbimit Social të qytetit ku ajo jeto, kjo për të adresuar më mirë nevojat e saj dhe të gjithë familjes.


PROFILI I RASTEVE TË REJA

- Vendet nga të cilat vijnë viktimat e trafikimit

Rastet e referuara në programin e D&E vijnë nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Kështu, 48 % e rasteve vijnë nga zona urbane kurse 52% e rasteve vijnë nga zonat rurale.




Nëse do ti referoheshim qarqeve të Shqipërisë nga vijë rastet e reja të referura në programin e D&E mund të themi se qarqet nga vjen edhe numri më të lartë i rasteve janë Tirana, Durrësi dhe Berati. Ndërkohë dy raste të asistuar nga D&E gjatë vitti 2012 janë shtetas të huaj.




- Gjinia e përfituesve

Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e rasteve të referuara tek D&E sipas gjinisë, ku edhe pse përqindjen më të madhe e zënë femrat, hap përpara konsiderohet identifikimi dhe referimi për të marrë shërbime riintegruese të viktimave meshkuj të trafikimit.



- **Mosha e përfitueseve**

Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm numri më i madh i rasteve të referuara në program gjatë vitit 2012 kanë qenë të grupmoshës 18-25 vjeç me 45% të rasteve; ndërkohë një përqindje të konsiderueshme për këtë vit kanë zënë edhe grupmoshat 14-17 vjeç (24%); 12% e rasteve kanë qenë të moshës 26-30 vjeç; 17% të grupmoshës 31-35 vjeç dhe 2% mbi 36 vjeç.




Përveç rasteve minorene të referuara në program, duke iu referuar rasteve të grupmoshave të tjera mbi 18 vjeç rezulton se 52 % e tyre janë shfrytëzuar kur kanë qenë të mitur/të mitura.

- **Niveli arsimor i rasteve të reja**

Nëse do të referoheshim nivelit arsimor të rasteve të reja, mund të themi se numri më i madh i rasteve që janë referuar në program gjatë këtij viti nuk kanë përfunduar as sistemin 8-9 vjeçar të detyrueshëm. Më pas një numër të konsiderueshëm zënë edhe rastet që kanë përfunduar sistemin e detyrueshëm shkollor dhe për arsye nga më të ndryshmet, kryesisht refuzimi i prindërve për ti lejuar të vazhdojnë më tej procesin e edukimit, e kanë ndërprerë atë. Domethënës është fakti që 5 nga rastet e referuar në program kanë

përfundur shkollën e mesme, ndërkohë që 2 raste të tjerë rezultojnë të kenë filluar universitetin. Njëri nga rastet e kishte braktisuar fakultetin që në muajt e parë, një rast tjetër e kishte përfunduar sistemin bachelor.



- Konteksti familjar

Pjesa më e madhe e rasteve të referuara në programin e D&E gjatë vitit 2012 vijnë nga familje me probleme social – ekonomike. Ku elementë të tillë si dhuna fizike dhe psikologjike kanë qënë fenomene shoqërues të jetës së tyre. Dhuna kryesisht është ushtruar nga pjestarët meshkuj të familjes. Një numër i konsiderueshëm rastesh vijnë nga familje me prindër të divorcuar, si rezultat i divorcit rastet kanë jetuar vetëm me njërin nga prindërit ose përveç prindit edhe me njerkun/ njerken. Nuk kanë munguar edhe rastet, të cilët pas divorcit të prindërve ose pas vdekjes së njërit prej tyre, kanë jetuar me gjyshërit.

Rastet e referuara në program gjatë këtij viti raportojnë se kanë ndjerë shpesh presionin e prindërve për t'u martuar kundër vullnetit të tyre. Martesa këto të nxituara që i kanë ekspozuar rastet ndaj risqeve të tjera. Mentaliteti i prindërve vazhdon të jetë një faktor përcaktues

Shqetësues mbeten rastet të cilat kanë qënë objekt incesti brenda familjes së tyre, kryesisht nga njerku, xhaxhai apo pjestarë të tjerë të rrethit të ngushtë familjar.


Duke iu referuar statistikave, 16 raste të referuara në program vijnë nga familje me prindër të divorcuar dhe 1 rast vjen nga familje ku njëri nga prindërit ka vdekur. 35% e këtyre rasteve kanë jetuar me njerkun. 1 rast është jetim dhe ka jetuar në jetimore.

- **Mënyrat e rekrutimit**

Përsa iu përket mënyrave kryesore të rekrutimit të viktimave përqindjen më të lartë e zënë **premtimet false për punë**, rreth 36% e rasteve të referuar në program gjatë këtij viti janë rekrutuar pikërisht në këtë lloj forme. Rasteve ju janë premtuar vende të sigurta pune dhe të mirëpaguara, ndërkohë që janë përballur më situata të mirëfillta shfrytëzimi, me mundësi lëvizje të kufizuara, me dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike të vazhdueshme etj. Dy nga rastet e rekrutuar në këtë formë kanë qënë shtetas të huaj të cilëve ju ishte premtuar mundësi punësimi më e mirë në Shqipëri.


Një tjetër formë rekrutimi është edhe **premtimi falas për akomodim, ushqim, mbrojtje dhe punë**. Duke shfrytëzuar situatat vulnerable të përfutueseve (marrëdhënie të vështira familjare, marrëdhënie abuzimi, martesa/ fejesa të detyruara etj) individë të ndryshëm iu janë afruar duke ju premtuar mundësi akomodimi dhe mbrojtjeje. Shpesh ndërmjetës në këtë drejtim kanë shërbyer persona që përfituesit u kanë besuar të tillë si shok ose shoqe, persona të ndryshëm të rrethit familjar etj.

Me përqindje të barabartë renditet **premtimi për martesë dhe martesa**, si një nga format që vazhdojnë të rekrutojnë një numër të konsiderueshëm viktimash. Për një sërë rastesh trafikanti ka qënë personi që ju ka premtuar martesë ose më të cilin kanë pasur martesë kryesisht fiktive dhe jo të celebruara. Vetëm një nga rastet e referuara gjatë këtij viti është rekrutuar me **anë të rrëmbimit**. Ky rast është trafikuar në një moshë shumë të re dhe është shfrytëzuar për vite me rradhë. Por edhe kur vajza ka mundur të shpëtojë për mungesë informacioni apo referimi nga strukturat përkatëse nuk ka marrë asnjë shërbim riintegres në përputhje me nevojat e saj. Vajza është referuar tek D&E nga Bashkia e Kuçovës.



- Statusi i përfitueseve të reja

Përsa i përket statusit të përfituesve të reja, pjesa më e madhe e tyre i pëkasin statusit beqare. Dy raste edhe pse me statusin beqare në momentin e referimit në program kanë qënë duke bashkëjetuar me partnerët e tyre, të cilët i kanë përfshirë në trafikim. Ndërkohë 3 përfituese kanë qënë të martuara në momentin e futjes në program. Dy prej tyre janë asistuar nga D&E për të filluar procedurat e divorcit nga bashkëshortët respektivë. Në njërin rast bëhej fjalë për një viktimë dhune dhe në rastin tjetër bëhej fjalë për bashkëshortin e përfitueses, që ishte edhe personi kyc që e kishte përfshirë atë në trafikim. Një përfituese tjetër ka pasur lidhje martesore fiktive me një shtetas anglez. Ndërkohë 2 raste të tjera në momentin e futjes në program kanë pasur statusin të divorcuara, të njëjtin status kanë pasur edhe kur janë përfshirë në trafikim.



- Llojet e shfrytëzimit të rasteve të reja

Rreth 65 % e rasteve të referuara në programin e D&E gjatë këtij viti kanë qënë të shfrytëzuara seksualisht gjatë procesit të trafikimit, ndërkohë 23% e rasteve janë shfrytëzuar për punë të detyruar dhe 12 % e rasteve janë shfrytëzuar për lypje.

Lloji i shfrytëzimit	Numri i rasteve
Shfrytëzim Seksual	32
Punë e detyruar	11
Lypje	6

Vlen të theksohet këtu fakti që disa raste janë shfrytëzuar për më shumë se një qëllim.

2. SHTYLLAT KRYESORE TË PUNËS SË D&E GJATË VITIT 2012

A. ASISTENCE DIREKTE PËR VAJZAT DHE GRATË VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Një paketë e plotë e shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrimit të D&E:

- Strehim, siguri dhe plan riintegrimi
- Asistencë e menjëhershme mjekësore
- Negocim/ndërmjetësim me familjen
- Vlerësime dhe këshillime psikologjike\Mbështetje dhe asistencë ligjore
- Asistencë për rregjistrim / vazhdimësinë e sistemit shkollor
- Trajnime profesionale
- Aktivitete sociale
- Këshillim dhe ndihmë për punësim
- Mbështetje financiare për strehim
- Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve
- Programe pune që krijojnë të ardhura
- Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit
- Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit

Janë realizuar në total 46 seanca art terapie (120 minuta secili).



Gjatë vitit 2012 janë ofruar në total 150 shërbime shëndetësore.

21 përfituese kanë ndjekur gjatë kësaj periudhe shkollën/ 7 përfituese janë rregjistruar në sistemin arsimor për herë të parë këtë vit shkollor

3246 seanca këshillimi në total janë ofruar për përfituesit e programit të riintegrit të D&E



Gjatë vitit 2012 - 21 përfituese kanë ndjekur kurse të ndryshme profesionale si parukeri, estetikë, babysitter, kuzhinë, si dhe kurse të kompjuterit dhe gjuhëve të huaja Anglisht e Italisht.

26 përfitues kanë qenë në marrëdhënie pune, të punësuar në pozicione të tilla pune si: kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, pjatatarësë, pastruese, ndihmëse parukiere, operatore në call center, etj.

Në Korrik të vitit 2012 u hap "Qendra për aktivitete edukative për Viktimat e Trafikimit"

Në këtë qendër ndodhet një ambient i vecantë për organizimin e Terapisë së Artit, terapisë Okupacionale dhe Kurseve të Muzikës. Një ambient i pajisur me kompjutera shërben për organizimin e kurseve të kompjuterit. Një ambient tjetër përfshin Bibliotekën dhe sallën e trajnimeve ku zhvillohen aktivitete të ndryshme. Një ambient i qetë dhe i vecantë është krijuar për zhvillimin e seancave psikologjike individuale dhe në grup.

Në bazë të një plani të përgatitur së bashku me përfitueset janë zhvilluar aktivitete si më poshtë:

Terapi arti- me rreth 17 përfituese pjesëmarrëse dhe rreth 23 sesione të organizuara, mbështetet nga psikologia e qendrës dhe një asistente.

Terapi Okupacionale- sesionet realizohen me ndihmen e një vullnetarje gjermane e cila ka përfshirë rreth 16 përfituese në 15 takimet e realizuara. Një ndihmë në këtë kurs ka dhënë edhe një vullnetare amerikane e cila organizoi rreth 3 sesione duke përfshirë 10 përfituese.

Diskutimet e Grupit dhe Sesionet Informative janë udhëhequr nga stafi përkatës dhe kanë trajtuar tema të ndryshme, të cilat shfaqin interes tek përfitueset të tilla si : të drejtat e njeriut, tema psikologjike, te përditshme dhe historike si "100 VJETORI I PAVARËSISË" dhe " SHENJTËRIMI I NËNË TEREZËS" . Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 10 përfituese.

Kinemaja në Shtëpi- është një aktivitet që ndiqet nga rreth 10 përfituese dhe janë mbajtur rreth 5 sesione që pasohen me diskutimin e filmit të parë.

Klubi I librit- frekuentohet nga 15 përfituese dhe udhëhiqet nga mësuesja e qendrës e cila ka organizuar rreth 15 takime. Aktiviteti synon komentimin e librave dhe diskutimin rreth tyre, dhe tashmë rreth 60 libra të rinj janë shtuar bibliotekës.

Kursi I kompjuterit- ndiqet nga 12 përfituese dhe janë organizuar 26 takime nën drejtimin e instruktorese së kompjuterit.

Këshillimi psikologjik- janë ofruar 253 seanca këshillimi individual nga psikologja e qendrës dhe menaxheret e rasteve.

Kurset e Muzikës- përfshijnë KURS KITARE dhe KURS PIANO. 6 përfituese kanë ndjekur sesionet e kursit të Kitares dhe 10 të tjera kanë ndjekur kursin e Pianos.

B. IDENTIFIKIMI DHE ASISTIMI I MESHKUJVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Gjatë vitit 2012 D&E i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ofrimit të shërbimeve riintegruese për meshkuj viktime trafikimi/ viktime të mundshme trafikimi. Gjatë vitit 2012 janë asistuar në program 8 meshkuj viktime trafikimi/ viktime të mundshme trafikimi. Nga këta, 2 raste maxhorenë me shtetësi Filipinase janë referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë dhe 6 rastet e tjerë (4 maxhorenë dhe 2 minorene) me shtetësi shqiptare janë referuar nga organizata ARSIS. 2 rastet me shtetësi Filipinase kanë bërë intervistën formale dhe kanë marrë statusin viktime trafikimi; ndërsa 6 rastet e tjera edhe pse janë shfrytëzuar, kanë kërkuar të mos e bëjnë intervistën formale në ambientet e Policisë duke mbetur në statusin viktime të mundshme trafikimi.

Lidhur me asistencën e ofruar për këtë kategori, 7 rastet janë asistuar në apartamente me qera dhe 1 rast në familje duke u ofruar: këshillim psiko-social; asistencë ligjore; asistencë mjekësore; mbështetje për gjetjen e një vendi pune; mbështetje financiare për pagesën e qerasë së apartamentit; trajnim për rritjen e aftësive për jetën; informim dhe ndërmjetësim për të marrë shërbimet që ofrohen në komunitet; monitorim dhe ndjekje të vazhdueshme. Për 2 rastet me shtetësi të huaj u bashkëpunua me IOM, AP dhe DPP për kthim e tyre në vendin e origjinës, vendim i marrë nga vetë përfituesit.

Studim mbi identifikimin dhe ndihmën ndaj meshkujve të trafikuar

Aktualisht D&E është në fazën finale të përfundimit të studimit mbi trafikimin e meshkujve në Shqipëri dhe nga Shqipëria.

Qëllimi i këtij studimi të D&E është: 1. Për të grumbulluar të dhëna krabasuar dhe analizuar kushtet në të cilat meshkujt shqiptarë kanë migruar dhe situatat në të cilat ata janë gjendur nëpërmjet instrumentave të sotme të identifikimit të trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë që të sensibilizohet publiku dhe aktorët e identifikues që situata të ekspozimit ndaj trafikimit të mos përsëriten dhe të ndërhyet në kohë sipas të gjitha standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare; 2. T'u jepet viktimave të trafikimit meshkuj mundësia të kuptojnë situatat në të cilat kanë kaluar dhe të venë në vend të drejtat e tyre nëpërmjet dhënies akses në sistemin e sotëm të identifikimit dhe referimit 3. Të kontribuohet në planifikimin e dhënien e ndihmës specifike e të përshtatshme për meshkujt viktime të trafikimit, 4. Të kontribuohet në zhvillimin në vend të një koncepti më të plotë për trafikimin e qenieve njerëzore, si një fenomen që prek edhe meshkujt e rinj e të rritur e jo vetëm gratë e fëmijët.

Të dhënat e grumbulluara nga instrumentet e përdorura në funksion të studimit janë duke u analizuar dhe shumë shpejt studimi do bëhet i njohur për aktorët e tjerë anti – trafik në Shqipëri.

C. PËRPJEKJE PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

- Këshillim dhe mbështetje për punësim për përfitueset

Gjatë vitit 2012, 26 përfitues kanë qënë në marrëdhënie pune, të punësuar kryesisht si: kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, pjatatarëse në restorant, pastruese, ndihmëse parukiere në sallon parukerie, operatore në call center, etj.

- Këshillim drejt punësimit

Dhjetë përfitues të programit të D&E janë bërë pjesë e “Ciklit të Këshillimit”. Qëllimi i këtij aktiviteti është të rrisë kapacitetet e tyre profesionale dhe individuale, duke synuar një punësim të sukseshëm në tregun e punës. Nën lehtësimin e një trajneri grupi realizon takime grupi ose individuale, në përputhje me nevojat e secilit përfitues dhe në përputhje me planin individual të zhvillimit.

Përfituesve që janë pjesë e “Ciklit të Këshillimit” do t’ju ofrohet mbështetje financiare për të ndjekur kurse të ndryshme të formimit profesional, për të bërë praktikë pune pranë kompanive private, për të hapur mikro-biznese etj.

- Hapjen e mikro - biznesve për viktimat e trafikimit për të mbështetur riintegrimin e tyre në komunitet

Gjatë këtij viti 5 përfitues të D&E janë asistuar e mbështetur për të hapur bizneset e tyre.

- 1 rast është mbështetur në hapjen e një dyqani për përgatitjen dhe shitjen e byrekëve.
- 1 rast është mbështetur të hapë një dyqan të vogël me artikuj të ndryshëm ushqimorë.
- 1 rast është mbështetur të hapë një dyqan për shitjen e rrobave të dorës së dytë.
- 1 rast është mbështetur për të hapur një sallon parukerie
- 1 rast tjetër u mbështet për të hapur një rrobaqepsi të vogël



- ***Pilotimi i programit të nxitjes së punësimit me kompanitë e biznesit***

D&E në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Drejtorinë Rajonale të Punësimit/ Tiranë ka filluar ndërmjetësimin me kompani biznesi private për të filluar pilotimin e programit të nxitjes së punësimit.

Katër viktimat të trafikimit të qënieve njerëzore do të punësohen pranë katër kompanive të sektorit privat duke u mbështetur për një periudhë 6 mujore me pagesën e rrogës si dhe sigurimeve shoqërore. Zbatimi i programi do i ndihojë përfituesit të fitojnë eksperiencë reale pune, si edhe të lehtësojë përfshirjen e tyre në tregun formal të punës.

- ***Punësimi i përfitueseve brenda organizatës D&E***

Dy përfituese kanë vazhduar të punojnë pranë organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, njëra në pozicionin e magazinieres dhe tjera në pozicionin e sanitares.

D. AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI

Aktivitetet ndërgjegjësuere të ndërmarra nga D&E gjatë vitit 2012 kanë synuar rritjen e respektimit të të drejtave të viktimave të trafikimit në shoqërinë shqiptare, duke synuar të luftojë stigmatizimin me të cilin viktimat e trafikimit përballën gjatë procesit të tyre të riintegrimin në shoqërinë shqiptare.

Një projekt specifik është zbatuar nga D&E për këtë qëllim: **“Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri - TI JAPIM FUND STIGMËS”**. Projekti është zbatuar në dy faza:

Faza e parë e projektit: Prill – Qershor 2012

Donator: Qeveria Australiane – Departamenti i Punëve të Jashtme dhe Tregëtisë (DAP)

Faza e Dytë e projektit: Shtator 2012 – Gusht 2013

Donator: Ambasada Amerikane në Tiranë

Aktivitetet kryesore të fazës së parë të projektit:

1. Krjimi dhe publikimi i fotonovelës “Kjo ishte historia ime”

Në funksion të këtyre aktiviteteve u krijua si mjet ndërgjegjësimi - fotonovela. Fotonovela paraqet një histori e vërtetë të një viktimë e trafikimit, duke filluar nga mënyra e rekrutimit, si ajo është ndihmuar të shpëtojë, shërbimet e nevojshme riintegruese, sfidat e procesit të riintegrimit të saj në shoqërinë shqiptare, nevoja e brendshme e saj për t'u pranuar dhe mbështetur nga familja, komuniteti etj.



2. *Workshope dhe forume në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë*

- U organizuan **workshope në 12 shkolla të mesme** në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë - rreth 360 nxënës morrën pjesë në këto aktiviteteve.
 - U organizuan **6 Forume me komunitetin** në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë – rreth 167 pjesëmarrës ishin pjesë e këtyre forumeve.
 - U organizuan **3 Workshope ndërgjegjësuere me punëdhënësit** në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë – 74 përfaqësues biznesi morën pjesë në këto workshope.
3. Përveç këtyre aktiviteteve në nivel vendor, u organizua në Tiranë edhe një workshop ku morën pjesë 36 pjesëmarrës, aktorë të rëndësishëm anti – trafik në Shqipëri. Në workshop u prezantuan aktivitetet e realizuara si dhe u diskutuan hapat e mëtejshme të adresimit të stigmës në bashkëpunimin me të gjithë institucionet. Pjesëmarrësit dhanë rekomandime të rëndësishme për vazhdimësinë e aktiviteteve për të adresuar çështjen e stigmës ndaj viktimave të trafikimit.

Aktivitetet kryesore të fazës së dytë të projektit:

- Prodhimi i materialeve të tjera ndërgjegjësuere si fletëpalosje, postera, si dhe riprodhimi i fotonovelës
- Workshope dhe forume me komunitetin në Berat, Durrës dhe Lezhë (3 në çdo qytet)
- Workshope me nxënësit e shkollave të mesme në Berat, Durrës dhe Lezhë (të paktën 5 workshope në çdo qytet)
- Workshope ndërgjegjësuere me punëdhënësit (të paktën 1 workshop në çdo qytet)
- Workshop final i organizuar me aktorët kryesorë anti –trafik në Shqipëri



Aktivitetet e realizuara deri tani në fazën e dytë të projektit:

- Është ribotuar fotonovela **“Kjo ishte historia ime”**/ 2000 kopje të saj janë përgatitur për t’u shpërndarë në aktivitetet e planifikuara
- Është përgatitur dhe botuar fletëpalosja **“Respekt për të drejtat e viktimave të trafikimit në Shqipëri – FUND STIGMËS DHE DISKRIMINIMIT!”** /2500 kopje
- Është përgatitur dhe botuar një poster/ 500 kopje
- Janë realizuar 2 workshope me nxënësit e shkollave të mesme të Beratit (një numër total prej 79 nxënësit morrën pjesë në to)
- Është realizuar një workshop me përfaqësues të Zyrës së Punës dhe të bizneseve të ndryshme që funksionojnë në Berat (një numër total prej 18 individësh morrën pjesë në të).

Një plan aktivitetesh është përgatitur për realizimin në kohë të aktiviteteve të projektit, ndërkohë që D&E në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar dhe partnerë të tjerë po planifikon që projekti të shtrihet në grupe të tjera si edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

Partnerë të ngushtë të projektit kanë qenë Ministria e Brendshme/ Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti –trafik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra e Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti –Trafik, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj.

E. AKTIVITETE PËR TË PARANDALUAR TRAFIKIMIN DHE PËR TË PROMOVUAR MIGRACIONIN E SIGURT

Aktivitete për të parandaluar trafikimin janë organizuar në kuadër të projektit: **“Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë”**.

Objektivi kryesor i këtyre aktiviteteve është puna për parandalimin e trafikimit dhe shfrytëzimit të migrantëve duke eksploruar strategjitë alternative për personat në rrezik trafikimi. Ky projekt po realizohet në Qarkun e Beratit/ Kuçovë. Në fazën e parë të projektit është bërë një vlerësim për të evidentuar strategjitë pozitive për migracionin e sigurtë dhe parandalimin e trafikimit. Është përgatitur një manual për burimet në komunitet dhe në vendin e destinacionit.

Projekti është në fazën ku është përzgjedhur një grup lehtësuesish nga vetë komuniteti të cilët do të prezantojnë për pjesën tjetër të komunitetit manualin informativ të përgatitur për migrantët, si edhe do të ndajnë me ta ekperiencat personale të migracionit.

Në vijim janë planifikuar të organizohen një sërë workshopesh me pjeshtarë të ndryshëm të komunitetit.

3. TRAJNIME TË OFRUARA NGA D&E

Gjatë vitit 2012 D&E në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Anti –trafik ka organizuar 5 trajnime me stafin e Zyrave Rajonale të Punësimit në Durrës, Shkodër, Lezhë, Fier dhe Beratit. Pjesëmarrës në trajnim ishin edhe punëdhënës përfaqësues të institucioneve publike dhe biznese private me të cilat Zyrat Rajonale të Punësimit bashkëpunojnë. ***Një total prej 121 pjesëmarrësish morrën pjesë në këto trajnime.***

Objektivat specifike të trajnimeve ishin:

- Të njiheshin specialistët e Zyrave Rajonale të Punësimit dhe përfaqësuesit e biznesit me specifikat dhe nevojat e target – grupit të viktimave të trafikimit;
- Të prezantoheshin me komponentët e riintegritit dhe rëndësinë e punësimit në procesin e riintegritit të viktimave të trafikimit;
- Të njiheshin me pasojat e trafikimit dhe parimet etike të punës me viktimat e trafikimit.

Kështu janë realizuar trajnimet e mëposhtme:

- 1. Durrës, 5 Prill 2012 dhe një total prej 27 pjesëmarrësish ndoqën trajnimin.***

2. *Shkodër në 29 Maj 2012 dhe një total prej 25 pjesëmarrësish ndoqën trajnimin.*
3. *Lezhe, 7 Qershor 2012 dhe një total prej 25 pjesëmarrësish ndoqën trajnimin.*
4. *Fier, 20 Qershor 2012 dhe një total prej 26 pjesëmarrësish morrën pjesë në trajnimin.*
5. *Berat, 12 dhjetor 2012 dhe një total prej 18 pjesëmarrësish morrën pjesë në takim.*



4. PJESËMARRJA E STAFIT NË TRAJNIME

- Trajnimi “Trajnim mbi rastet e vështira, vlerësimi i rrezikut për veten dhe të tjerët, supervizimi i kolegëve në raste të vështira” ofruar nga PHD. Philip Jaffe.
- Workshop mbi “Përdorimin e databases dhe analizës së të dhënave”, organizuar nga IOM.
- ‘Teknika relaksimi – menaxhim stresi”, organizuar nga një terapistë indiane.
- “Teknika të reja për familjet dhe fëmijët” Eagle WINGS.
- Nismat Anti – korrupsion në sistemin e drejtësisë: program për Ngritjen e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillimin dhe Zbatimin e Projekteve kundër Korrupsionit, organizuar nga USAID/ Programi JUST.
- Trajnim mbi “Sistemin e Drejtësisë dhe Shkrimin e Projekt – propozimeve”, organizuar nga USAID/ Programi JUST.
- Trajnim mbi “Te drejtat Ekonomike të grave & Identifikimi, raportimi dhe advokacia në fushën e të drejtave të grave në tregun e punës”, organizuar nga Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim.
- Trajnimi “Planifikim familjar për fëmijët”, organizuar nga shoqata “Krahët e Shqiponjës”.
- Trajnimi “Metoda të reja për fëmijët dhe familjet”, organizuar nga shoqata “Krahët e Shqiponjës”.

5. KOORDINIME ME AKTORË TË TJERË KUNDËR TRAFIKIMIT

D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti –Trafik, takimet e Komitetit Shtetëror kundër trafikimit, organizuar nga Ministira e Brendshëm.

D&E ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti –trafik. Gjatë kësaj periudhe D&E ka pasur edhe lidhshirin e këtij Koalicioni.

D&E si anëtare e KKSAT dhe në bashkëpunim me IOM Tirana ka organizuar në 5 Dhjetor 2012, ëorkshopin “Bashkëpunimi i shoqërisë Civile dhe Komuniteti të Biznesit për të luftuar trafikimin e qenijeve Njerëzore”.

Gjatë kësaj periudhe D&E së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile kanë forcuar bashkëpunimin me inctitucionin e Avokatit të Popullit, duke u fokusuar kryesisht në dhunën me bazë gjinore dhe barazinë gjinore.

6. PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE TE ZBATUARA GJATË 2012

Projekti 1: “Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri’

Donator: King Boudouin Foundation

Kohëzgjatja: 18 muaj

Projekti 2: “Sigurimi i asistencës riintegruese të qëndrueshme për Viktimat e Trafikimit dhe atyre në risk trafikimi”

Donator: MFA, IOM, UNODC, MIVA.

Kohëzgjatja: 2004 - në vazhdim

Projekti 3: “Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë”.

Donator: Ministria e Jashtme Norvegjeze

Kohëzgjatja: 2 vjet

Projekti 4: “Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri - ti japim fund stigmës”

Faza e parë e projektit

Donator: Ambasada Australiane ne Athine/DIRECT AID PROGRAM

Kohëzgjatja: Prill- Qershor 2012

Faza e Dytë e projektit

Donator: US Embassy in Tirana

Kohëzgjatja: Shtator 2012 – Gusht 2013

Projekti 5: “ Mbështetje për Qendrën e Rinintegritimit për Viktimat Shqiptare të Trafikimit”

Donator: TWIG

Kohëzgjatja: Maj- Qershor 2012

Projekti 6: “Ndjekja e përpjekjeve Anti –Trafik – Forcimi i anti-trafikimit shqiptar”

Donator: IOM

Kohëzgjatja: Janar- Shtator 2012

Projekti 7: "Qender për aktivitete edukative për Viktimat e Trafikimit"

Donator: IBVM (Loreto)

Kohëzgjatja: 2 vjet

Projekti 8: “Cikli i këshillimit”

Donator: Swiss Contact

Kohëzgjatja: 14 muaj